

# Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca e OSBE-së në Shqipëri



# Çfarë bëjmë

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka mandat të përkrahë demokratizimin, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut si dhe të konsolidojë institucionet demokratike në përputhje me parimet, standardet dhe angazhimet e OSBE-së.


Në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me qeverinë e Shqipërisë dhe me institucione dhe organizata të tjera shtetërore, Prezenca e OSBE-së u ofron ndihmë dhe ekspertizë autoriteteve shqiptare dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Prezenca u krijua në vitin 1997, pas rënies së firmave piramidale, për të ndihmuar në stabilizimin e vendit dhe për të koordinuar ndihmën ndërkombëtare.

Sot, veprimtaritë e Prezencës variojnë nga kontrolli i armëve dhe lufta kundër trafikimit deri tek asistenca zgjedhore; nismat kundër korrupsionit; mbrojtja e të drejtave të njeriut; reforma legislative, reforma gjyqësore dhe reforma e medias; ndërtimi i kapaciteteve të zyrtarëve të zbatimit të ligjit; integrimi gjinor dhe siguria mjedisore.



Thellimi i marrëdhënieve dhe ndërtimi i urave përmes të rinjve forcon mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe miqësinë. Rinia luan një rol parësor për promovimin e angazhimit qytetar dhe integritetit rajonal.



Fushata e Prezencës kundër dhunës në familje i ka fuqizuar qytetarët dhe i ka intensifikuar përpjekjet e autoriteteve në bashkëpunim me opinionin publik për t'i ofruar një mbrojtje më të mirë viktimave dhe ndjekje penale më të shpejtë autorëve.



Prezenca bashkon qytetarët e shqetësuar, vendim-marrësit dhe aktorë të tjerë të fushës për të trajtuar sfida të mëdha për vendin, sikurse ndotja mjedisore.

# Si punojmë

Për të arritur një ndryshim jetëgjatë, Prezenca shfrytëzon ekspertizën e saj të brendshme, njohuritë institucionale dhe marrëdhëniet e kultivuara prej një kohe të gjatë me aktorët e ndryshëm, duke u përkushtuar për një periudhë të qëndrueshme dhe duke u përqendruar tek institucionet, si dhe duke ndihmuar në formësimin e politikave dhe strategjive. Kjo qasje siguron efikasitet, koherencë dhe ndikim të punës së Prezencës duke i trajtuar problemet nga drejtime të ndryshme.

Prezenca e OSBE-së punon në koordinim dhe partneritet me një serë aktorësh shqiptarë dhe ndërkombëtarë dhe ka një qasje më rajonale. Prezenca e bën këtë falë mbështetjes së 57 Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, ndër të cilët përfshihet dhe Shqipëria.

## Nxitja e ndryshimit të qëndrueshëm

Strukturat dhe ligjet nuk mjaftojnë. Prezenca punon që të arrihet:

- Zbatimi kuptimplotë dhe i paanshëm i ligjit;
- Funkcionimi i efektshëm dhe saktë i institucioneve;

- Krijimi i marrëdhënies së besimit ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve, si dhe ndërmjet kundërshtarëve politikë.

Prezenca lehtëson konsultimet për reformat, duke bashkuar të gjithë aktorët e interesuar në një proces dhe nxit marrëdhëniet mes institucioneve.

Si partnere afatgjatë e Shqipërisë, qëllimi përfundimtar i Prezencës është të zhvillojë kulturën e shtetit të së drejtës, respektimin e vlerave, si dhe fuqizimin dhe respektimin e qytetarëve.

## Ndërtimi i urave të bashkëpunimit

Një nga pikat e forta të Prezencës është aftësia për të ndërtuar ura dhe për të bashkuar njerëzit – për të bashkëpunuar përtej kufijve, për të trajtuar sfida dhe për të rritur përpjekjet për pajtim.

Puna e Prezencës së OSBE-së përfshin mbështetjen për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe sigurimin e një pjesëmarrjeje gjithëpërfshirëse të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, si dhe ndihmën për institucionet shqiptare në trajtimin e sfidave si dhuna në familje, korrupsioni dhe ekstremizmi i dhunshëm.

I kushtohet vëmendje mënyrës se si qytetarët ndërveprojnë me demokracinë, duke vlerësuar se qytetarët kanë rolin e tyre në monitorimin dhe vendosjen e standardeve për funksionimin e duhur të institucioneve. Prezenca thekson si përgjegjësitë ashtu dhe të drejtat.



Prezenca ka ndihmuar partnerët lokalë në shumë përpjekje të rëndësishme legjislative gjatë dekadës së fundit, duke përfshirë mbështetjen e hartimit të një kodi sjelljeje për deputetët në Kuvend.

## Aktivizimi i pjesëmarrjes së qytetarëve

Duke përforcuar ndjenjën e angazhimit qytetar, fuqizimit dhe përgjegjësisë mes qytetarëve shqiptarë, sidomos grave, të rinjve dhe anëtarëve të grupeve të cenueshme, Prezenca ndihmon që atyre t'u dëgjohet zëri.

Nismat e Prezencës për shoqërinë civile të fokusuar tek komuniteti ndihmojnë qytetarët të kuptojnë se si funksionon demokracia dhe u jep atyre aftësitë dhe përvojën që ta bëjnë atë të funksionojë për ta.

Prezenca ka nxitur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e të rinjve, pakicave dhe të personave me aftësi të kufizuara dhe ka ndihmuar në rritjen e përfaqësimit të grave në politikë.

Në planin afatgjatë, qytetarët aktivë janë monitoruesit më të mirë të demokracisë së tyre.

# Si punojmë

(vazhdon)

## Zbatimi i projekteve me përparësi

Prezenca ka marrë pjesë në mënyrë aktive, me kërkesë të partnerëve vendas, në shumë prej reformave më të rëndësishme të dhjetëvjeçarit të fundit, duke përfshirë edhe reformën zgjedhore dhe reformën në drejtësi. Ajo rishikon dhe komenton projektligje, përkrah dhe lehtëson konsultimet me publikun dhe këshillon në lidhje me hartimin e zbatimit e politikave të reja.

Me mandatin e saj të larmishëm, Prezenca tregon

zhdërvjelltesë për t'iu përgjigjur kërkesave të momentit të fundit për ekspertizë dhe për financim të projekteve pilot.

Prezenca ka udhëhequr ose ka kontribuar ndjeshëm në një numër të madh projektesh, që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e popullsisë shqiptare. Kjo përfshin përpjekjet për largimin dhe shkatërrimin e municioneve të tepërta konvencionale dhe materialeve të rrezikshme kimike, ndihmën që u është dhënë autoriteteve për identifikimin dhe mbrojtjen më të mirë të viktimave të trafikimit dhe për përmirësimin

e efikasitetit të proceseve gjyqësore.

## Shteti i së drejtës fillon nga ty

Prezenca po punon në mënyrë aktive për të krijuar kulturën e shtetit të së drejtës në Shqipëri, ku ligjet të jenë të qarta, të drejta, të parashikueshme dhe të zbatohen për të gjithë në mënyrë të barabartë. Kultura e shtetit të së drejtës është baza e përparimit në të tre dimensionet e OSBE-së – parakusht për sigurinë, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, demokracinë

funkionale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Individët nuk janë thjesht përfitues pasivë të shtetit të së drejtës. Me anë të zgjedhjeve dhe veprimeve të tyre, ata janë kontribues, njësoj si institucionet. Nuk bëhet fjalë vetëm për sistem gjyqësor të paanshëm dhe të besueshëm, por për kulturë të shtetit të së drejtës ku çdo qytetar merr pjesë. Ky është mesazhi i fushatës ndërgjegjësuese të Prezencës: “Shteti i së drejtës fillon nga ti” – nga çdo veprim i çdo qytetari.

# Fakte dhe shifra

(deri në qershor 2017)

## Kryetari i Prezencës



**Ambasadori Bernd Borchardt** nga Gjermania (që nga tetori 2016)

## Stafi



20 ndërkombëtarë dhe 63 vendas

## Buxheti vjetor



**2,892,700 Euro**

## Ndiqni OSBE



## Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Sheshi “Italia”  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 223 59 93  
Fax: +355 4 223 59 94

E-mail: [pm-al@osce.org](mailto:pm-al@osce.org)  
[www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)  
[twitter.com/OSCEinAlbania](https://twitter.com/OSCEinAlbania)  
[facebook.com/OSCE.Albania](https://facebook.com/OSCE.Albania)